



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 588/22

Nr. 597/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105; 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje prej Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, Vedat Poterqoi-Referuese, Kimete Gashi-Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik GOE "Lulzim Beqiri B.I & Infra Plus SH.P.K.& Eae-Njaz SHPK" me seli në Deçan dhe ankesës së OE "VB TOFAJ" SH.P.K." seli në Junik, të parashtruara kundër Vendimit të AK për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac" me numër të prokurimit 632-22-8235-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 28.12.2022, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "VB TOFAJ"SH.P.K." seli në Junik, e datës 28.10.2022, kurse Vendimi i AK për dhënie të kontratës i datës 10.10.2022, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac" me numër të prokurimit 632-22-8235-5-2-1, **Anulohet** kurse ky aktivitet i prokurimit kthehet në **Rivlersim**.
2. Refuzohet ankesa e GOE "Lulzim Beqiri B.I &Infra Plus SH.P.K.& Eae –Njaz SHPK" me seli në Deçan e datës 25.10.2022 për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac" me numër të prokurimit 632-22-8235-5-2-1.
2. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën mos respektimi i këtij vendimi, detyron OSHP të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues konform nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të sigurimit të ankesës, për OE GOE "Lulzim Beqiri B.I &Infra Plus SH.P.K.& Eae –Njaz SHPK" me seli në Deçan dhe për OE "VB TOFAJ"SH.P.K." seli në Junik, me ç'rast ankuesit kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 33 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.10.2022, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin e Vendimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac” me numër të prokurimit 632-22-8235-5-2-1.

Me 12.10.2022, kundër Vendimit të cituar si më sipër, GOE “Lulzim Beqiri B.I & Infra Plus SH.P.K. & Eae-Njaz SHPK” me seli në Deçan kishte ushtruar Kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK, të datës 17.10.2022. Po ashtu dhe OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” seli në Junik, kishte ushtruar kërkesë për rishqyrtim, kundër Vendimit të cituar si më sipër, e cila po ashtu është refuzuar nga AK me Vendimin e datës 17.10.2022.

Me 25.10.2022, OE “GOE “Lulzim Beqiri B.I & Infra Plus SH.P.K. & Eae –Njaz SHPK” me seli në Deçan, ndërsa me datën 28.10.2022 OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” seli në Junik, kanë parashtruar ankesë në OSHP (Protokolli 588/22 dhe 597/22), kundër vendimit të AK B58- Njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit (numër dhe datë), përshkruar si më sipër.

Me rastin e vlerësimit preliminar, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP, vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit e kanë statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat në të dyja rastet përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, do të thotë se ankesat në rastin konkret, i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe të njëjtat bienë nën kompetencat e këtij Institucioni në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 09.11.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesat të aprovohen si të bazuara
- Aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim..

Raporti i vlerësimit është pranuar nga të dyja palët, me ç’ rast GOE “Lulzim Beqiri B.I & Infra Plus SH.P.K. & Eae –Njaz SHPK” me 10.11.2022, ka deklaruar se pajtohet me disa konstatime të ekspertit ndërsa me disa jo duke dhënë arsye në përgjigje, ndërsa OE “VB TOFAJ”SH.P.K.”

me 10.11.2022 ka kthyer po ashtu përgjigje sipas së cilës është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, përderisa AK nuk ka kthyer përgjigje ne raportin e ekspertit shqyrtues.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli konstatoi në vijim se:

- Përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 449.988.13 €;
- GOE “Lulzim Beqiri B.I &Infra Plus SH.P.K.& Eae-Njaz SHPK” ka atakuar me ankesë vendimin e cituar si më sipër të AK për dhënie të kontratës, duke pohuar mes tjerash se gjatë rrjedhjes së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim me nenet Neni 1,6,7,59 dhe 60 të LPP. Po ashtu dhe OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” ka atakuar të njëjtin Vendim të AK, duke pohuar mes tjerash se gjatë rrjedhjes së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim me nenet Neni 51, 59 të LPP-së si dhe nenin 41.5 dhe 41.12 të RRUOPP.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tije i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP dhe Rregulloren e Punës, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të të paraqitura gjatë një aktiviteti të prokurimit. Lidhur me këtë Paneli shqyrtues konsideron se:

a) Pretendimet ankimore të OE ankues GOE “Lulzim Beqiri B.I &Infra Plus SH.P.K.& Eae -Njaz SHPK” janë të bazuara duke u bazuar në raportin e ekspertit shqyrtues i cili ka konstatuar se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të këtij OE, nga se i njëjti ka plotësuar kërkesën e AK, nisur fakti se i njëjti ka ofruar pajisjen e kërkuar nga AK (pajisjen me peshën 25t) prandaj PSH vendosi si në pikën 3 të këtij dispozitivi. Mirëpo pas administrimit të pretendimeve ankimore të OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” të parashtruara kundër GOE “Lulzim Beqiri B.I &Infra Plus SH.P.K.& Eae -Njaz SHPK” rezultojnë si të bazuara dhe si i tillë është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit duke u mbështetur ne raportin e ekspertit të specifikuar me poshtë.

b) Kurse, lidhur me pretendimet ankimore të OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” të parashtruara kundër OE të rekomanduar për dhënie të kontratës OE “REA Sh.p.k & SHALA Sh.P.K. Paneli mori në konsideratë vetëm pretendimin ankimor 1 dhe 2 të listuara me poshte, lidhur me rrjedhën e marrjes së vendimit përfundimtar dhe nuk e konsideron të nevojshme që pretendimet tjera lidhur me OE rekomanduar për kontratë, të shqyrtohen në detaje. Më tej Paneli vëren se:

1. Nga provat e ofruara kuptohet se mbështetja/qasja në kredi është e kushtëzuar nga autoritetet bankare. Kështu, në Letrën e ofruar nga RBKO thuhet, cituar “*nëse klienti i plotëson kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës për një kredi të tillë*”. Në kuptim të kësaj letre, PSH konsideron se mbështetja nga Banka është e kushtëzuar dhe se pretendimi ankimor në këtë aspekt është i bazuar në raport me DT sipas së cilës është kërkuar, cituar: “*Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 200.000,00 euro, ose qasje në kredi të pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia*”. PSH konstaton se kjo kërkesë nuk është e plotësuar nga lideri i GOE të rekomanduar (bazuar në shkresat e lëndës) pra nuk janë konform kërkesës së lartëcekur të DT.

2. Kurse, lidhur me kriterin si në vijim “*Dëshminë se ka përfunduar me sukses kontrata të trajtimit të shtratit të lumenjve (rregullim, pastrim të shtratit), ose trajtimit të ujërave të zeza, ose ndërtim-trajtimit të pendave dhe objekteve tjera lumore, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 675.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontratat të përfunduara me sukses*” PSH konstaton se kjo kërkesë nuk është e plotësuar nga lideri i GOE të rekomanduar sepse kontratat e përfunduara (bazuar në shkresat e lëndës) nuk janë konform kërkesës së lartëcekur të DT.

Pretendimet ankimore të OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” të parashtruara kundër OE “Lulzim Beqiraj B.I &Infra Plus SHPK & Eae Njaz SHPK” se nuk ka plotësuar kërkesat e DT. PSH mbështet arsyetimin dhe mendimin e ekspertit shqyrtues rreth këtyre pretendimeve ankimore. Andaj, GOE “Lulzim Beqiri B.I &Infra Plus SH.P.K.& Eae –Njaz SHPK” është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimet ankimore të OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” të parashtruara kundër OE ROZA KOMANI BI, janë jo relevante sepse ky OE është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit dhe meqë nuk ka ushtruar ankesë nuk konsiderohet palë me interes.

Paneli shqyrtues konstaton se AK nuk ka zbatuar drejt dispozitat e nenin 59 dhe 60 të LPP-së, duke e bere ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në kundërshtim me dispozitën e lartcekur për aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe dispozitën e nenit 7 të LPP-së po ashtu obligohet që vlerësimin ta beje konform kërkesave të dosjes së tenderit.

- Përfundim -

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues erdhi në përfundimin se me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit, AK nuk i ka marr në konsideratë dispozitat e nenit 1,7 dhe 59 të LPP, andaj me rastin e rivlerësimi AK është i obliguar që vlerësimin e ofertave ta bej në pajtim me dispozitat e lartcekura duke mos diskriminuar apo favorizuar asnjërin nga OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit dhe se vlerësimi i ofertave duhet berë vetëm në bazë të kriterëve të vendosura në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për kontratë , duke mos e eliminuar asnjë ofertues

për kritere të cilat nuk janë paparaparë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Prandaj Paneli shqyrtues duke u bazuar në provat e administruara, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, konform nenit 117 të LPP.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj – Mexhuani

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x1 AK – **Kuvendi Komunal Gjakovë**

1x1 GOE “Lulzim Beqiri B.I & Infra Plus SH.P.K.& Eae –Njaz SHPK” me seli në Deçan

1x1OE “VB TOFAJ”SH.P.K.” seli në Junik

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së